



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:029692

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05462286

P.nr.72/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të akuzuarit: Sh. B., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5209/2023 të dt.27.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt. 14.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Menduhi Kastrati, dhe të akuzuarit me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Av. A. E., në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 18.03.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH. B., nga i ati J. dhe nëna S. mbiemri i vajzërisë së nënës J., i lindur më datë, me vendbanim në Rr. “D. B.” pn, në Podujevë, me numër personal të identifikimit:..... ka të kryer shkollën e mesme, profesioni bujk, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar–Kosovar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Me datë 08.08.2023, rreth orës 22:10, në rrugën “D. B.”, në Podujevë, i pandehuri Sh. B. pas një mosmarrëveshje të atëçastshme nga vetura e tij kishte marr një shkop druri dhe me të e kishte goditur dy herë në kraharonin e majtë të dëmtuarin E. S. me ç’rast i dëmtuari pëson ënjtje të indeve të buta dhe gjak mbledhje nën lëkurore në regjionin ballor të anës së majtë të kokës të shkaktuara nga mjeti i fortë mbrojtës “jo i mbrojtës, i topitur” dhe si të tilla kualifikohen në lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin.

-me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 185 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449, 452, 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

- I. Të akuzuari me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 600.00€ (gjashtëqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.
- III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- IV. I dëmtuari E. S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.5209/2023 të dt.27.02.2024, kundër të akuzuarit: Sh. B., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 14.03.2024, në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Menduhi Kastrati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. A. E., ndërsa në seancë gjithashtu ka prezantuar prindi i të dëmtuarit E. S., F. S., i cili ka njoftuar gjykatën se e kanë pranuar ftesën për seancë, mirëpo djali i tij në këtë rast i dëmtuari nuk gjendet në Kosovë, por gjendet jashtë vendit në Kroaci, gjykatës i ka propozuar që të mbahet shqyrtimit fillestar pa praninë e të dëmtuarit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: E pranoj fajësinë është e vërtet si në aktakuzë, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, me familjen e E. jemi pajtuar nuk kemi asnjë problem, i kërkoj falje edhe njëherë prindit të dëmtuarit i cili gjendet këtu në seancë, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Mbrojtësja e të pandehurit Av. A. E. lidhur me praninë e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: Pas konsultimit me të mbrojturin tim, i njëjti më njoftoi se deri te shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor ka ardhur për shkak të disa mosmarrëveshje që ka pasur me palën e dëmtuar, pas këtij rasti kanë rregulluar raportet në mes palëve dhe familjarëve të tyre, i pandehuri punon edhe është person familjar, praninë e fajësisë dhe raportet e rregulluara në mes tyre kërkoj nga gjykata që ti merr rrethana lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnetin e tij të plotë nga i pandehuri bazuar në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtëses së të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarve, kështu që i njëjtit penalisht është përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, raportet e rregulluara me palën e dëmtuar, kërkim faljen për veprën e kryer penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata duke vlerësuar këto rrethana ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marrë në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër

të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.72/2024 me dt.18.03.2024

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.